

NOTERISE  
NOTERISE TIRANE



Regj. Nr. 49 Kol.

Tirane, me 17.01.2005



## KONTRATE SHITJE PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E PAKETES SHTETERORE TE AKSIONEVE PREJ 26,4 % (njetzet e gjashte presje kater%) TE

“ALB- MS 97” SH.A. TIRANE

Sot, me date 17.01.2005 (dymije pese), ditën e hënë, ne Agjencine Kombetare te Privatizimit, Tirane, perpara meje noteres se Dhomes se Noterise Tirane, Z. H. Robo, hartohet kontrata e shitjes se paketes se aksioneve prej 26.4 % e barabarte me 25.771 (njetzetepesemije e shtateqind e shtatedhete e nje) aksione te “ALB-MS 97” Sh.A.Tirane, e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.13004 Akt. date 04.12.1995, ndryshuar me Vendim Nr.13004/1 Akt, date 27.02.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.13004/2 Akt, date 18.07.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.13004/3 Akt, date 10.06.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.13004/4 Akt, date 11.06.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.13004/5 Akt, date 11.11.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.13004/6 Akt, date 09.11.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.13004/7 Akt, date 30.01.2004 te Gjykates se Rrethit Tirane.

midis paleve te cilat rane dakord si me poshte :

### Neni 1 - Palet

**1.1 Pala shitesë:** Agjencia Kombetare e Privatizimit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem i saj, **Z. Zihni BEQIRAJ**.

**1.2 Pala blerese** Shoqeria “ALBECORP” Sh.p.k, perfaqesuar me procure te Pergjithshme Nr. 103 Rep., 9 Kol., date 10.01.2005 nga **Zonja Edlira Margilaj** e bija e Nikollaqit dhe e Aliqit, e lindur me 29.03.1968, banuese ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me mumer pasaporte 0034646, e njohur me autorizimin Nr.3823 Prot., date 22.11.2004 te Agjencise Kombetare te Privatizimit, per kryerjen e pagese se vlefte se plote te paketes shteterore te aksioneve prej 26.4 % te “ALB-MS 97” Sh.a., Tirane.



## **Neni 2 - Objekti i kontrates**


Objekt i kesaj kontrate eshte shitja (transferimi) e 26.4% te aksioneve e barabarte me 25 771 (njezetepesemije e njeqind e shtatedhjet e kater) aksione te zoteruara nga Shteti Shqiptar, perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise, ne " Alb-MS 97" Sh.a.Tirane, me vlere 25.771.000(njezetepesemilion e shtateqind e shtatedhjet e njemije) leke.

## **Neni 3 - Çmimi i shitjes.**

- 3.1** Çmimi i shitjes se paketes se aksioneve prej 26.4% te zoteruar nga shteti ne shoqerine "ALB-MS 97" SH.A.Tirane eshte 25.771.000 (njezetepesemilion e shtateqind e shtatedhjet e njemije) leke, paguar plotesisht nga pala blerese ne Raiffesen BANK, ne favor te Agjencise Kombetare te Privatizmit, numri i llogarise 4302 (Dega e thesarit Tirane).
- 3.2** Pala shiteses deklaroi se ne favor te saj eshte derdhur e gjithë shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate bazuar ne ~~MA Nr. 00060 date 18.11.2004~~ per 7.734.300 (shtatemilion e shtateqind e tridhjetekater mije e treqind) leke te Raiffesen BANK dhe Mandat arketimi Nr. 00065 date 17.12.2004 per 18.042.700 (tetembedhjetmilion e dyzetedy mije e shtateqind) lek, leshuar nga Raiffesen BANK. Vlefte totale e paguar nga pala blerese eshte 25.777.000 (njezetepesemilion e shtateqind e shtatedhjet e shtatemije) leke.


## **Neni 4 - Kushtet e shitjes**

- 4.1** Pala blerese gjykohet se ka njohuri te plota per paketen e 26.4 % te aksioneve te ofruara per shitje.
- 4.2** Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shiteses ne autorizimin Nr 3823 Prot, date 22.11.2004 (dymije e kater).
- 4.3** Pala blerese pas nenshkrimit te kesaj kontrate, noterimit te saj behet pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me regjistrimin e kesaj pakete aksionesh prej 26.4 % e barabarte me 25 771 aksione qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.
- 4.4** Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia prej 26.4 % e aksioneve e barabarte me 25 771 aksione te Sh.A. "ALB-MS 97" Tirane transferohet nga Ministria e Ekonomise tek Shoqeria "ALBECORP" Sh.p.k Tirane, ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.



## **Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit**

- 5.1.** Bleresi ka pranuar blerjen e paketes shteterore prej 26.4 % te aksioneve te Sh.A. "ALB-MS 97" Tirane sipas Shkreses Nr. 3077 Prot., date 20.10.2004 te Agjencise Kombetare te Privatizimit Tirane si dhe Shkreses, date 14.11.2004 te Shoqerise "ALBECORP" Sh.p.k Tirane.
- 5.2** Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi paketen prej 26.4 % te aksioneve te kesaj shoqerie pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.
- 5.3.** Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e kesaj kontrate shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.
- 5.4.** Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per rregjistrimin e pasurive te paluajteshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajteshme te Rrethit Tirane.



## **Neni 6 - Te drejtat dhe detyrimet e shitesit.**

- 6.1.** Pala shitesese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te shtetit mbi paketen prej 26.4 % te aksioneve te SH.A. "ALB-MS 97" SH.A.Tirane, te ofruara per blerje pales blerese.
- 6.2.** Pala shitesese garanton bleresin per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine mbi kete objekt kontrate perballe organeve gjyqesore ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo kerkohet

## **Neni 7 -Baza ligjore per lidhjen e kontrates**

1. Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
2. Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
3. Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
4. Ligji Nr. 8334, date 23.04.1998
5. VKM.Nr.119, date 18.03.2002;
6. Udhezimi i VKM. Nr.119, date 18.03.2000;;
7. Urdheri i Ministrit te Ekonomise Nr. 330, date 11.10.2004
8. Shkresa date 14.11.2004 e shoqerise "ALBECORP" Sh.p.k Tirane





**Neni 8 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate**

- 8.1 Urdheri i Ministrit te Ekonomise, Nr.330, date 11.10.2004, per privatizimin e paketes prej 26.4 % te SH.A" ALB-MS 97" Sh.a Tirane me nje flete.
- 8.2 Autorizimi Nr.3823 Prot., date 22.11.2004, per kryerjen e pageses se vleres se plote te paketes se aksioneve prej 26.4 % te SH.A.,"ALB-MS 97" Sh.a Durres leshuar nga Agjencia Kombetare e Privatizimit me dy flete.
- 8.3 Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit me Nr.6313, 12.10.2004 me nje flete origjinal.
- 8.4 Planimetria e shoqerise se bashku me akt vleresimin e truallit.
- 8.5 Harta treguese e shoqerise derguar nga ZRPP Tirane.
- 8.6 Shkresa date 14.11.2004 e Shoqerise "ALBECORP" Sh.p.k Tirane.
- 8.7 Prokura e Pergjithshme Nr. 103 Rep, Nr. 9 Kol, date 10.01.2005 si dhe Vendimi Nr. 12234/4 date 21.01.2004 i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.
- 8.8 Mandat arketimet e pageses se paketes shteterore te aksioneve.



100 LËKË  
RISHODITËSE

**Neni 9 - Te ndryshme**

- 9.1 Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate, me kerkesen e paleve perplohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe me nga 4 faqe, prej te cilave nje kopje qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjencise Kombetare te Privatizimit, nje kopje i dergohet Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane nje kopje i dergohet Ministrise se Ekonomise dhe nje kopje i jepet pales blerese.
- 9.2 Pala shitesese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote, po keshtu edhe pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote. Ne kete moment palet e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim. Une noterja ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.



PALET KONTRATUESE

PALA SHITSESE

AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT

ZIHNU BEQIRAN

*Zihnu Beqiran*  
DREKTORI PERGJITHSHEM I AKP

REPUBLIKA SHQIPËRISE  
ZHYRA E NOTERËVE TIRANË  
Nr. 330 Rep Dt 10/2/05  
VERTETIM

Vertetimi i kësaj kopje është e  
niere me origjinalin Dokumenti  
U Parant  
550 lëkë

NOTER AGIM ROBO

*Agim Robo*  
NOTER


PALA BLERESE

Shoqeria "ALBECORP" Sh.p.k

Perfaqsuar me Prokura nga

Zj. Edlira Marghaj

*Edlira Marghaj*  
F.B.O.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 103 Rep  
Nr. 8 Kol.



PROKURE E PERGJITHESHME

Sot me date 10, 01, 05, para meje noter Agim Xh. Robo, me zyre ne rruger  
"Ismail Qemali", Pll.27/1 u paraqit personalisht:

**I PERFAQESUARI:** Zoti Irfan Hysenbelliu, i biri i Hasanit, dl.08.04.1959, lindur ne  
Skrapar dhe banues ne Tirane. Rr."Vaso Pasha" pl.8, me nr. Dok.1762730

Me zotesi juridike e te plote per te vepruar qe me vullnetin e tij te lire kerkoj nga une  
hartimin Prokures se Pergjitheshme baze nenit 70, 71 te KCivil si vijon:

" Une i perfaqesuari **IRFAN HYSENBELLIU** jam zoterues dhe pronar i plote mbi  
kuotat dhe aksionet e shoqerive tregetare te regjistruara ne Regjistrin Tregetar ne  
gjykaten e shkalles se pare Tirane, te cilat specifikohen perkatesisht ne vendimet  
bashkengjitar kesaj prokure.Me vullnetin tim te plote dhe te pavesuar:

**"Emeroj perfaqesuese te plotefuqishme** ne te drejta te pakufizuara z.Edlira Margila,  
dl.1968, banuese Tirane, nr.dokumenti 0034646, e cila do:

1.Te kryeje te gjitha veprimet juridike ne emer dhe per llogarine time.

- te njihet si I vetmi person I autorizuar para personave te trete ne procedura te negociimit/ perpimit dhe nenshkrimt te marreveshjeve me persona fizike juridike private dhe ente publike e shteterore, qe lidhen me veprimtarite sipas objektit, qe une ushtroj me zoterimin ekskluziv ne shoqerite tregetare si ne ato ku perfaqesuesja ka funksionin e Administratores ashtu edhe ne shoqerite tjera pa kufizim.

2.Te nenshkruaje ne kontrata shitje, blerje,

- te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerive me pergjegjesi te kufizuar (para noterit)
- te aksioneve ne shoqerite anonime,(nepermjet urdher xhirimeve).
- te shlyeje vlefat perkatese si dhe te arketoje ato.

3.Te jete perfaqesuesja ime zyrtare qe do te marre kontakt me personelin administrativ te cdo institucioni,

- te kerkoje dhe nenshkruaje dokumenta qe lidhen me veprimtarite e shoqerive te mia,
- te nenshkruaje ne akte qe lidhen me investime ne keto shoqeri nepermjet kontratave me te trete,
- te kontraktoje me shoqeri te tjera per ushtimin e bashkepunimit tregetar dhe te nenshkruaje ne keto marreveshje.

4.Te marre cdo informacion te hollësishem dhe te administroje veprimtarite e shoqerive ne pronesine time te plote

- te monitorojë ecimin e sctyre veprimtarive ne aspektin ekonomik e financiar, te kontaktoje me drejtuesit teknike te tyre, eksperte kontabel te autorizuar.

5. Te marre kredi, te nenshkruaje ne kerkesen drejtuar entit kredidhenes, te plotesoje e nenshkruaj dokumentat e vena ne dispozicion,

- teape garancite e nevojshme per marrjen e kredive.
- te ushtroje te drejten e vendosjes se barres apo pengjeve mbi kapitalin apo pasurite e shoqerive per efekte te garantimit te shlyerjes se kredive.
- te depozitoje firmen e saj e cila do te jete e para ne kryerjen e veprimeve (transaksione, transferime, llogari rjedhese) etj me institucionet bankare qofshin ato shtetere apo private.

6. Te kontestojë per cdo rast ne te cilin cenohen interesat e mia tregetare para personave drejtues te institucioneve shtetere apo private, te paraqese kerkesa, ankesa ndaj veprimeve te tyre.

- te me perfaqesoje para cdo zyre arbitrazhi ne rast te zgjidhjes se konflikteve te mundeshme.

7. Te lidhe kontrata qeraje, huapardorie, huaje, ne emrin tim, duke perfaqesuar shoqerite perkatesisht sipas rastit.

Per veprimet juridike te kryera, perfaqesuesja eshte e detyruar te me njoftoje ne cdo shtet duke me vene ne dispozicion edhe aktet e nevojshme. Per te dhe veprime te tjera qe nuk jane permendur shprehimisht por jane te nevojshme per tu kryer, Perfaqesuesja ime nuk ka asnje kufizim prej meje dhe ato i quaj te mireqena njelloj si t'i kisha kryer vete. Keto veprime do te kryhen prej saj edhe ne mungesen time, me detyrimin e venies ne dijeni. Te tregt jane te detyruar te njohin zyrtarisht veprimet e Perfaqesueses sime. Per cdo njoftim, korrespondence, aktet do te dergohen dhe nenshkruhen prej saj.

Sa me siper Prokura mu lexua me ze te larte prej noterit, deklaroj se e kuptoj permbajtjen e saj dhe jam dakort me te, nenshkruaj pa asnje verejtje."

Une noterit qe hartova prokuren ne perputhje me vullnetin e lire te te perfaqesuarit dhe aktin e giej ne pajtim me ligjin, vertetotj rregullisht.

Prokura e pergjitheshme, u hartua ne baze te nenit 70,71 te KC, Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe baze nenit 39 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine". Permbajtja e saj perfshin 2( dy) flete te lidhura, ne pese origjinale. Njeri prej tyre depozitohet prane zyres se noterise, te tjerat z. Irfan Hysenbelliu.

Prokura eshte e vlefshme dhe do te perdoret bashkengjitur edhe Vendimet gjyqesore te regjistrimit te shoqerive (sh.p.k.) dhe (sh.a) ne pronesi te te perfaqesuarit.

**I PERFAQESUARI**

**AKSIONER dhe ORTAK I VETEM**

*Irfan Hysenbelliu*  
*[Signature]*



**NOTER**

*[Signature]*